



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2023

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2022

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 158, të Kushtetutës, dhe të nenit 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Neni 1

Miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit

Miratohet buxheti faktik, si raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit, për vitin 2022, sipas dokumenteve të mëposhtme, që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse të tij:

- a) Pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, për vitin 2022;
- b) Raporti për zbatimin e buxhetit vjetor 2022, në nivelin e fondeve të miratuara dhe objektivat e realizuar;
- c) Raporti për borxhin publik dhe përbërjen e tij, për vitin 2022;
- ç) Raporti për përdorimin e fondit rezervë dhe të kontingjencës, për vitin 2022;
- d) Raporti për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, gjatë vitit 2022.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. _____, datë _____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT
FAKTIK TË VITIT 2022”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 62 e 63, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2022”, për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DELINA IBRAHIMAJ